



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:171942

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05498408

P.nr.40/2023

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sadri Krasniqi, me zyrtaren ligjore Donjeta Zenuni, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurve sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1178/2023, të datës 04.08.2023 dhe Marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.6/2024, të datës 20.03.2024, më datë 21.03.2024, hartoi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ND.nr.6/2024, e datës 20.03.2024, e lidhur ndërmjet palës së dëmtuar R. A., nga fsh.Sllatinë e Epërme Komuna Viti dhe të pandehurve A. M. nga Vitia ,Rr. Hebib Sejdiu dhe H. A. nga Vitia Rr.,,Shotë Galica'' , përkitazi me Aktakuzën PP.II.nr.1178/2023, e datës 04.08.2023.

II. H U D H E T aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.1178/2023, e datës 04.08.2023.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurve A. M. , për shkak të veprës penale: Vjedhja nga neni 313, paragrafi 1, të KPRK-së dhe H. A. për shkak të veprës penale: ndihma në vjedhje ,nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së , *pasi që në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.*

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën, PP.II.nr.1178/2023, e datës 04.08.2023, ka propozuar që ndaj të pandehurve A. M. nga Vitia ,Rr. Hebib Sejdiu , për shkak të veprës penale: Vjedhja nga neni 313, paragrafi 1, të KPRK-së dhe H. A. nga Vitia Rr.,„Shotë Galica’’ për shkak të veprës penale:ndihma në vjedhje ,nga neni 313 paragrafi 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtimin fillestar kundër të pandehurit për datë 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore prezantonin, Prokurorja e shtetit,ndërsa munguan të pandehurit A. M. dhe H. A. dhe i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit R. A. Pasi që munguan të pandehurit gjykata konstatoi se nuk ka kushte ligjore për mbajtjen e kësaj seance gjyqësore dhe seancën e sotme e shtyu për kohë të pacaktuar, ndërsa lënda ju dërgua me vendim bashkëpunëtorit profesional për ta referuar në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të pandehurit, më datën 18.03.2024, lëndën i ka dërguar për procedurë të mëtutjeshme Referentit për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjilan-dega në Novobërdë.

Referenti për ndërmjetësim më dat.20.03.2024, e njofton Gjykatën se lidhur më çështjen penale P.nr.40/2023, më 20.03.2023, pranë kësaj Gjykate, në procedurën e ndërmjetësimit është lidhur Marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar me nr. ND.6/2024, në mes të pandehurve A. M. dhe H. A. dhe të dëmtuarit R. A. nga fsh. Sllatinë e Epërme , K.e Vitisë.

Gjykata, pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se në këtë çështje penale duhet hedhur aktakuzën e lartcekur të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, si dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurve A. M. dhe H. A. , ngase më datë 20.03.2024 në mes palëve është arritur marrëveshja në procedurë të ndërmjetësimit.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, duke u bazuar në nenin 229, paragrafi 4, të Kodit të Procedurës Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2023:171942, 25.03.2024

Gj y q t a r i,

Sadri Krasniqi, d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.